



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ prot.,

Tiranë, 28.07.2025

NJOFTIM

Inspektorati i Përgjithshëm kërkon të marrë me qira ambiente për zyra.

Në bazë të Urdhërit me Nr. 450/7 prot., datë 28.07.2025, të Inspektorit të Përgjithshëm, për marrje me qira ambiente zyrash për akomodimin e punonjësve të Inspektoratit të Përgjithshëm, shpallim njoftimin:

Ambientet që do të merren me qira nga ana e Inspektoratit të Përgjithshëm duhet që të plotësojnë kërkesat e mëposhtme;

- *Specifikit teknike të domosdoshme janë si më poshtë:*

Nr.	Kategoria	Përshkrimi i Specifikimit
1	Karakteristikat teknike mbi sipërfaqen e ambientit	Referuar sipërfaqes ekzistuese e Inspektoratit të Përgjithshëm, është llogaritur se për akomodimin i punonjësve nevojitet një sipërfaqe jo më pak se 1100^1 m^2 .
2	Numri i punonjësve	Ambienti duhet të përbushë nevojat për akomodimin e 98 punonjësve.
3	Struktura e brendshme	Hapësirë e tipit ‘Open Space’, e cila do të organizohet në momentin e lidhjes së kontratës me zyra për punonjësit, sallën e mbledhjeve, arkivën, magazinën, zonën e pritjes së qytetarëve, si edhe tualete të ndara për gra dhe burra.
4	Infrastrukturë IT	Rrjet LAN/ËiFi, prizë për çdo vend pune, hapësirë për server.
5	Ndriçim, ventilim dhe furnizim me energji elektrike dhe ujë.	Ndriçim natyral dhe sistem funksional ajrimi/ngrohjeje. Furnizim i rregullt me energji elektrike dhe ujë të pijshëm (me matës të dedikuar). Pa detyrime të papaguara.
6	Aksesueshmëri	I aksesueshëm për Inspektoratet Qendrore, me akses nga rrugë kryesore dhe linja urbane, ashensor nëse ndërtesa është me kate.

7	Sisteme sigurie	Kamera sigurie, alarm, dalje emergjente, fikëse zjarri dhe certifikatë kolaudimi.
8	Parkim	Hapësira për të paktën 10 automjete zyrtare.
9	Mirëmbajtje teknike	Garanci për mirëmbajtje teknike të ambientit.
10	Akses 24/7	Ambienti të jetë i aksesueshëm në çdo kohë për punonjësit.

* Në ambientet ekzistuese të Inspektoratit të Përgjithshëm ndodhen pajisje të paçmontueshme si, serverat e sistemit online dhe kullat e karikimit të automjeteve elektrike, për rrjetin ambienti i ri me qira preferohet brenda Unazës së Madhe.

- *Specifimet ligjore të domosdoshme janë si më poshtë:*

Nr.	Kategoria	Përshkrimi i Specifikimit
1	Dokumentacion ligjor	<ul style="list-style-type: none"> - Certifikatë pronësie e lëshuar nga ASHK ose, në mungesë të saj, një vërtetim zyrtar nga ASHK që konfirmon se prona është në proces legalizimi apo certifikimi të titullit të pronësisë. - Ekstrakt i QKB-së nëse pronari është person fizik apo juridik; - Vërtetim nga ASHK që objekti nuk është në proces gjyqësor; - Deklaratë notariale që objekti është i lirë nga barra dhe i gatshëm për përdorim institucional.

Fondi limit i procedurës së marrjes me qira për ambjente për zyra për Inspektoratin e Përgjithshëm është **2 987 lekë/m2**.

Fondi limit për 1-post parkimi është **20 895 lekë/muaj**.

Afati i kontratës së qiradhënieς të jetë jo më pak se 1 vit, me të drejtë rinovimi.

Pagesa e qirasë do të bëhet çdo muaj kundrejt lëshimit të faturës tatimore. Në rast se qiradhënesi është individ dhe nuk mund të lëshojë faturë tatimore, pagesa e detyrimeve tatimore do të kryhet nga Inspektorati i Përgjithshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi për taksat e tatimet dhe shuma e detyrimeve do t'i zbritet qiradhënesit nga vlera e qirasë.

Objekti që do të merret me qira duhet t'i vihet në dispozicion qiramarrësit brenda 7 ditëve nga njoftimi për lidhje kontrate, me opsjon shtyrje edhe për vitet e tjera nëse do të jetë e nevojshme.

Shënim: Dokumentacioni i kërkuar duhet të jetë në formën e tij ligjore (i njehsuar me origjinalin) dhe i lëshuar brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ofertës.

Ofertat, me kriteret si më sipër, duhet të paraqiten deri në datën **05.08.2025, ora 10.00**, në zyrën e protokollit të Inspektoratit të Përgjithshëm.

Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.

Shpallja e fituesit do të shpallet në faqen zyrtare të Inspektoratit të Përgjithshëm www.insq.gov.al.